

VENDIM
Nr. 25, datë 22.2.2024

**MBI PËRCAKTIMIN E ÇMIMIT TË BLERJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE TË
PRODHUAR NGA PRODHUESIT EKZISTUES ME PËRPARËSI NGA BURIMET
FOTOVOLTAIKE PËR VITIN 2023**

Në mbështetje të neneve 10, pika 2, 16 dhe 19 të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; nenit 10, pika 5 të ligjit nr. 24/2023, “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme”; vendimit të Këshillit të Ministrave (VKM) nr. 369, datë 26.04.2017, “Për miratimin e metodologjisë për përcaktimin e çmimit të blerjes së energjisë elektrike të prodhuar nga burimet e vogla të rinovueshme nga dielli dhe era”; VKM-së nr. 580, datë 28.8.2019, “Për miratimin e planit të konsoliduar kombëtar të veprimit për burimet e rinovueshme të energjisë, 2019–2020”; nenit 15 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s në mbledhjen e tij të datës 22.2.2024, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur me nr. 632 prot., datë 14.2.2024 nga Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve “Mbi përcaktimin e çmimit të blerjes së energjisë elektrike të prodhuar nga prodhuesit ekzistues me përparësi nga burimet fotovoltaike për vitin 2023”,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 179, datë 29.5.2023, vendosi për “Fillimin e procedurës për përcaktimin e çmimit të blerjes së energjisë elektrike të prodhuar nga prodhuesit ekzistues me përparësi nga burimet fotovoltaike dhe eolike për vitin 2023”.

- ERE, me shkresën nr. 1800 prot., datë 15.6.2023, ka njoftuar Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE), Shoqatën Shqiptare e Energjisë së Rinovueshme (AREA), Shoqatën e Investitorëve të Huaj (FIAA), si dhe Furnizuesin e Tregut të Lirë (FTL) sh.a., në lidhje me fillimin e procedurës për përcaktimin e çmimit të blerjes së energjisë elektrike të prodhuar nga prodhuesit ekzistues me përparësi nga burimet fotovoltaike dhe eolike për vitin 2023.

- ERE me shkresën nr. 1914 prot., datë 13.7.2023, i ka kërkuar MIE-s informacion lidhur me subjektet që kanë nënshkruar një kontratë për zhvillim projekti me MIE ose janë pajisur me miratim paraprak për ndërtimin e kapacitetit prodhues, deri në momentin e hyrjes në fuqi të ligjit nr. 24/2023 “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme”,

- MIE me shkresën nr. 5938/1, datë 1.8.2023, protokolluar në ERE me nr. 1914/1, datë 3.8.2023, është shprehur se: Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë bazuar në VKM nr. 822, datë 7.10.2015, “Për miratimin e rregullave dhe procedurave të ndërtimit të kapaciteteve të reja prodhuese të energjisë elektrike, që nuk janë objekt koncesioni”, e ndryshuar, për vitin 2022–2023 ka dhënë miratime përfundimtare dhe paraprake për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese të energjisë elektrike fotovoltaike me kapacitet 2 mw.

- ERE, me shkresën nr. 1914/2 prot., datë 5.12.2023, kërkoi informacion mbi të dhënat dhe dokumentet referuese, mbi të cilat ERE mund të mbështetet për përcaktimin e çmimit të blerjes së energjisë elektrike të prodhuar nga prodhuesit ekzistues me përparësi për vitin 2023, në zbatim të legjislacionit në fuqi.

- MIE, me anë të shkresës nr. 5938/3, datë 18.12.2023, protokolluar në ERE me nr. 1914/3, datë 19.12.2023, ka përcjellë në ERE të dhënat dhe dokumentacionin e kërkuar, nga ku rezultoi se vetëm njëri prej subjekteve u përket miratimeve të dhëna nga MIE për vitin 2023.

- ERE, me anë të shkresës nr. 256, datë 25.1.2024, ka kërkuar sërish nga MIE vënien në dispozicion të të dhënave të përditësuara, në lidhje me pjesën e mbetur të subjekteve që kanë marrë miratimin për

ndërtimin e impianteve të reja gjeneruese të energjisë elektrike fotovoltaike me kapacitet të instaluar deri në 2 mw për vitin 2023.

- MIE, me anë të shkresës nr. 998/1, datë 8.2.2024, protokolluar në ERE me nr. 256/1, datë 9.2.2024, përcolli në ERE informacionin e përditësuar në kuadër të monitorimit nga Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore (AKBN) të kontratave për ndërtimin, shfrytëzimin dhe administrimin e impianteve gjeneruese të energjisë elektrike fotovoltaike, të paraqitur nga subjektet të cilat janë pajisur me miratim për ndërtimin e impianteve gjeneruese të energjisë elektrike fotovoltaike me kapacitet deri në 2 mw për vitin 2023.

- Pas analizimit të dokumentacionit të vënë në dispozicion nga MIE për shoqëritë të cilat janë Mbajtëse të Miratimit Përfundimtar për ndërtimin e impianteve gjeneruese fotovoltaike deri në 2 mw si dhe mbështetur në legjislacionin në fuqi, vlerësojmë se në lidhje me përcaktimin e çmimit të blerjes së energjisë elektrike të prodhuar nga prodhuesit ekzistues me përparësi nga burimet fotovoltaike për vitin 2023:

- Mbështetur në pikën 37, të nenit 3, të ligjit nr. 24/2023, “Prodhues ekzistues me përparësi” – *është një prodhues me përparësi që në momentin e hyrjes në fuqi të këtij ligji ka nënshkruar një kontratë për zhvillim projekti me ministrinë ose është pajisur me miratim paraprak për ndërtimin e kapacitetit prodhues fotovoltaike deri në 2 mw, eolike deri në 3 mw dhe për hidrocentrale me kapacitet të instaluar deri 15 mw.*

- Në lidhje me Metodologjinë përkatëse, Këshilli i Ministrave nuk ka miratuar ende metodologjinë, por mbështetur në pikën 2 të nenit 31, *aktet nënligjore të dala në bazë dhe në zbatim të ligjit nr. 7/2017, “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme”, të ndryshuar, vazhdojnë të mbeten në fuqi dhe të zbatohen deri në momentin e miratimit të akteve nënligjore në zbatim të këtij ligji.*

- Në zbatim të pikës 2 të nenit 31 të ligjit nr. 24/2023, Metodologjia e miratuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 369/2017, e ndryshuar, vijon të mbetet në fuqi. Kjo metodologji do të shërbejë për miratimin e çmimit të blerjes së energjisë elektrike nga burimet e vogla të rinovueshme nga dielli deri në 2 mw dhe era deri në 3 mw për prodhuesit ekzistues me përparësi *që në momentin e hyrjes në fuqi të këtij ligji kanë nënshkruar një kontratë për zhvillim projekti me ministrinë ose është pajisur me miratim paraprak për ndërtimin e kapacitetit prodhues.*

- VKM nr. 369, datë 26.4.2017, “Për miratimin e metodologjisë për përcaktimin e çmimit të blerjes së energjisë elektrike të prodhuar nga burimet e vogla të rinovueshme nga dielli dhe era” përcakton formulën dhe komponentët përbërës të përlllogaritjes së LCOE për teknologjitë fotovoltaike dhe eolike.

- VKM nr. 580, datë 28.8.2019, “Për miratimin e planit të konsoliduar kombëtar të veprimit për burimet e rinovueshme të energjisë, 2019–2020”, i ndryshuar, shpreh vlerësimin më të fundit të kryer nga qeveria shqiptare sa i takon komponentëve të tjerë të LCOE, si WACC, periudha e mbështetjes dhe orët mesatare të punës për prodhimin e energjisë elektrike në vendin tonë nga burimet e rinovueshme të energjisë.

- Lidhur me koston e investimit dhe komponentët e LCOE në tërësi, janë marrë në konsideratë kostot e investimit dhe shpenzimet vjetore operative dhe degradimi vjetor që rezultojnë nga Planet e Biznesit të përditësuara të projektzbatimeve të shoqërive, të cilat janë mbajtëse të miratimeve përfundimtare për ndërtimin e impianteve fotovoltaike me fuqi të instaluar deri në 2MW si dhe mbështetur në vlerësimet e VKM-së nr. 580/2019 elementët e tjerë përlllogaritës si WACC, periudha e mbështetjes si dhe orët mesatare të punës së impianteve fotovoltaike për vitin 2023.

- Në zbatim të sa më sipër për përlllogaritjen e çmimit të blerjes së energjisë të prodhuar nga prodhuesit ekzistues me përparësi nga burimet fotovoltaike për vitin 2023 jemi referuar modelit të Excel-it të AGORA-s në studimin e saj për Shqipërinë.

- Për ndjekjen dhe vlerësimin e burimeve të rinovueshme, të cilat kanë hyrë në operim si dhe ato që pritet të hynë në të ardhmen, ligj nr. 24/2023 parashikon rolin e Agjencisë përgjegjëse për energjinë

e rinovueshme, e cila ndër të tjera do të ketë detyrën e monitorimit të kontratave koncesionare dhe atyre jo objekt koncesioni për ndërtimin e burimeve të reja prodhuese të energjisë elektrike si dhe të përmbushjes së detyrimeve kontraktuale, përlllogaritjen dhe aplikimin e penaliteteve të shoqërisë për mospërmbushje detyrimesh, testimin e impianteve prodhuese dhe lëshimin e certifikatës së përfundimit të impiantit sipas kontratës së nënshkruar, vlerësimin dhe certifikimin e investimit të kryer.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Miratimin e çmimit të blerjes së energjisë elektrike të prodhuar nga prodhuesit ekzistues me përparësi nga burimet fotovoltaike me kapacitet të instaluar deri në 2 mw prej 95.04 euro/MWh, për vitin 2023.

2. Çdo ndryshim në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi, do të përbëjë shkak për rishikimin e këtij vendimi nga ERE.

3. Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve të njoftojë te palët e interesit, Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, Furnizuesin e Tregut të Lirë, Shoqatën Shqiptare të Energjisë së Rinovueshme dhe Shoqatën e Investitorëve të Huaj në Shqipëri për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARE NË DETYRË
Erjola Sadushi